

CRNA GORA
MALI I ZI
OPŠTINA ULCINJ
KOMUNA E ULQINIT
Sekretarijat za kulturu
sport , mlade i dr. djelatnosti
Sekretarijati per kulturë.
sport, rini dhe vep. shoqërore
Br./nr: 16-614/24 - 3814
Ulcinj/Ulqin, 05.02.2024.godine

Në bazë të nenit 10. të Vendimit për financimin e sportit në teritorin e Komunës së Ulqinit („Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 27/21.), Sekretariati për kulturë, sport, rini dhe veprimtari shoqërore, shpall

KONKURS PUBLIK

për bashkëfinancimin e programeve të punës të organizatave sportive për vitin 2024.

KUSHTET PËR BASHKËFINANCIM TË PROGRAMEVE TË PUNËS

Objekt i konkursit është alokimi i mjeteve nga Buxheti i Komunës së Ulqinit për vitin 2024. për bashkëfinancimin e programeve të punës të organizatave sportive të cilat nuk i ka themeluar, përkatësisht bashkëthemeluar Komuna e Ulqinit, e bazuar në nenin 9. të Vendimit për financimin e sportit në teritorin e Komunës së Ulqinit („Fl. zyr. MZ – dispozitat e komunës“, nr. 27/21.) dhe nenit 4. të Rregullores për kushtet, mënyrën, procedurën dhe kriteret më të përafërta për alokimin e mjeteve për organizatat sportive nr. 03-040/21-709/1 të datës 03.09.2021.

Të drejtë për të marrë pjesë në konkurs kanë klubet sportive, të cilët janë të regjistruar në teritorin e Komunës së Ulqinit, i cili është i rregulluar me një sistem unik të garave në kuadër të federatës kombëtare kompetente. Klubet sportive, shoqëritë sportive rekreative mund të lajmërohen në konkursin publik për bashkëfinancim një vit pas ditës së themelimit të klubit ose shoqëritë sportive rekreative.

Përveç këtyre kushteve të drejtën për bashkëfinancimin e programeve të punës organizata sportive mund ta realizojë nëse i plotëson këto kushte:

- Që është e regjistruar në Organizatën sportive të Ministrisë së sportit dhe të rinjve;
- Që e ka selinë e klubit në teritorin e Komunës së Ulqinit së paku një vit nga dita e themelimit;
- Që klubi sportiv merr pjesë në sistemin e rregullt të garave që i organizon lidhja kombëtare sportive e Malit të Zi në një disiplinë të caktuar sportive (nuk ka të bëjë me shoqatat sportive rekreative dhe shoqatat sportive shkollore dhe të studentëve);
- Që ka të angazhuar ekspertin i cili ka kualifikimet e parapara me ligj për punën në sport;
- Që ka të siguruar ambientin për ushtrimin e veprimtarisë së vet;
- Që nuk ka bllokadë të llogarisë afariste dhe borxhe tatimore;
- Që deri në fund të vitit kalendarik aktual, i ka dorëzuar raportin financiar organit të administratës lokale për shpenzimin e mjeteve të ndara nga buxheti i Komunës së Ulqinit për vitin kalendarik i cili i paraprinë vitit në të cilin bëhet alokimi i mjeteve.

KRITERET PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË PUNËS, PËRKATËSISHT PËR ALOKIMIN E MJETEVE JANË:

- Masiviteti;
- Tradita e ekzistencës së klubit;
- Organizimi i garave shtetërore dhe ndërkombëtare;
- Vlerësimi me pikë i sporteve ekipore (radhitja e garave, vlerësimi me pikë i numrit të ligave sipas niveleve të garave, suksesi i arritur i seniorëve në kampionatin kombëtar, suksesi i realizuar i të gjitha kategorive në Kupën e Malit të Zi.
- Vlerësimi me pikë i sporteve individuale (suksesi i arritur në Kampionatin kombëtar, suksesi i arritur në Kupën e Malit të Zi;
- Numri i anëtarëve në ekipin kombëtar në vitin për të cilin bëhet vlerësimi;
- Vlerësimi me pikë i suksesit të arritur të anëtarëve të kombëtares në garat ndërkombëtare në sportet ekipore dhe individuale;
- Vlerësimi me pikë i sporteve olimpikë.

APLIKIMI NË KONKURS

Aplikimi në konkurs bëhet në formularin e paraparë të Sekretariatit për kulturë, sport, rini dhe veprimtari shoqërore, në adresën: Komuna e Ulqinit – Sekretariati për kulturë, sport, rini dhe veprimtari shoqërore, në zarf të mbylluar, me shenjën KONKURSI për bashkëfinancimin e programeve të punës të organizatave sportive për vitin 2024, ku është dokumentacioni i përmendur i nevojshëm për konkurim. Aplikimi bëhet me postë ose në sportelin e Byrosë së qytetarëve të Komunës.

Formulari i aplikimit mund të merret në web sajtin e Komunës ose në sportelin e Byrosë së qytetarëve.

Afati për paraqitjen e aplikimit në konkurs është 15. ditë nga dita e publikimit.

Të drejtën për bashkëfinancimin e programit të punës nuk do ta realizojë parashtruesi i aplikimit i cili nuk i plotëson kushtet e kërkuara me konkurs, nëse ka dorëzuar dokumentacionin jo të plotë ose që të dhënat e kërkuara pasaktësisht i ka paraqitur.

Aplikimet e vonuara dhe jo të plota nuk do të shqyrtohen. Konkursi është publikuar në web faqen e Komunës, në tabelen e shpalljeve të Komunes së Ulqinit, si dhe në median lokale Radio Ulqini.

Informacione shtesë mund të merren te Sekretariati për kulturë, sport, rini dhe veprimtari shoqërore, tek këshilltari i pavarur për sport Alban Gjoni, në telefonin 067 119 221.

V.D. SEKRETARJA
Aldina Nikečević

